



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA  
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 99 Dt. 23.02.2023  
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe në bazë të kërkesës për inicim te procedurës disiplinore nga Komisioni i Garave, Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 23.02.2023 merr këtë:

## VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e Komisionit të Garave të FBK-së e datës 30.01.2023.
- II. LIROHET nga përgjegjësia Lindrit Misinin (zyrtar i KB Trepça).

## ARSYETIM

Me datë 01.02.2023, pas publikimit të Informatorit nr.20/2023, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore, në lidhje me ndeshjen mes KB Trepça dhe KB Golden Eagle Ylli, xhiroja XX e Prince Caffè Superligës së Kosovës (edicioni 2022/23). Në bazë të Informatorit nr.20/2023 supozohet se, Lindrit Misini, anëtar i Bordit dhe person zyrtar i KB Trepçës, ka tentuar të sulmojë gjyqtarin Elldin Uglari dhe në vazhdimësi ka ofenduar gjyqtarët e ndeshjes, deri në largimin e tyre drejt zhvështoreve nga Policia e Kosovës.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 10.02.2023, 14.02.2023, dhe 23.02.2023. Në takime kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Sekretarja e Përgjithshme e FBK është autorizuar nga KD për të kërkuar deklarata nga akterët dhe dëshmitarët e përfshirë në këtë rast. Komisioni Disiplinor ka pasur në dispozicion deklarata me shkrim nga: Elldin Uglari (gjyqtar i ndeshjes), Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës), Dren Pudarolli (gjyqtar i ndeshjes), dhe Artan Gashi (gjyqtar kryesor i ndeshjes).

## Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Pas pranimit të deklaratave, më 14.02.2023, Komisioni Disiplinor shqyrtoi provat në dispozicion dhe konstatoi se ato nuk mjaftojnë për të marrë vendim përfundimtar. Si rrjedhojë, në bazë të nenit 39 të Rregullores Disiplinore, deri në marrjen e vendimit final, Lindrit Misinit i'u shqiptua pezullimi 7 ditë nga pozita e tij si zyrtar i paraqitur në dokumentacionin e KB Trepça në FBK. Antarët e Komisionit u dakorduan të kërkohet deklaratë edhe nga Besim Braha (anëtar i shtabit teknik tek KB Trepça), i cili ka qenë në vend të ngjarjes. Së fundi, u vendos të ftohen në takim në zyret e FBK-së dy personat e përfshirë, z.Lindrit Misini dhe gjyqtari Elldin Uglari.

Në takimin e fundit, më 23.02.2023, konform ftesës paraprake, u prit z. Lindrit Misini i cili dha mbrojtjen e tij, ndërsa gjyqtari Elldin Uglari ka refuzuar ftesën e Komisionit Disiplinor duke mos u paraqitur në takim.

Komisioni Disiplinor, gjatë trajtimit të incidentit, ka shqyrtuar provat, deklaratat, mbrojtjen e z.Misinit, dhe dokumentet në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

### **1. Kompetenca e KD për të shqyrtuar rastin**

Komisioni i Garave të FBK-së, bazuar në Raportin e ndeshjes, ka publikuar Informatorin nr.20/2023. Aty është marrë vendim për dënimin e KB Trepça me një ndeshje pa shikues konform nenit 49.17 të Propozicioneve të Garave. Sipas nenit 55.8 të Propozicioneve të Garave, shqiptimi i çfarëdo dënimi sipas Propozicioneve mund të shërbejë si bazë për hapjen e procedurës disiplinore ndaj ekipit apo pjesëtarit shkelës të tyre. Rrjedhimisht, konsideruar përfshirjen e Lindrit Misinit në incident, Komisioni i Garave ka inicuar procedurë disiplinore ndaj Lindrit Misinit (KB Trepça).

### **2. Meritat e Vendimit**

Pas shqyrtimit të provave, si: deklaratat nga Elldin Uglari (gjyqtar i ndeshjes), Dren Pudarolli (gjyqtar i ndeshjes), Artan Gashi (gjyqtar kryesor i ndeshjes), Besim Braha (zyrtar i KB Trepça), mbrojtjes së dhënë nga Lindrit Misini (person zyrtar i KB Trepçës), si dhe videot e siguruara nga KB Trepça, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar sipas bindjes së lirë në bazë të provave të lartpërmendura.

## **Kosovo Basketball Federation**

Supported by:



General Sponsor:



**TEB**

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

Në mangësi të provave që vërtetojnë se Lindrit Misini ka tentuar të sulmojë fizikisht gjyqtarin Elldin Uglari, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se, duke u bazuar në video inçizimin nga disa kënde, shihet se Lindrit Misini ka qenë prezent në parket, mirëpo i njëjti nuk ka tentuar të kryejë ndonjë veprim ndaj gjyqtarit Uglari apo treshes së gjyqtarëve të asaj ndeshje. Për më tepër, nga video inçizimet vërehet z.Misini gjatë lëvizjes në parket nuk e ka pasur në fokus gjyqtarët. Andaj, u vendos si në dispozitiv.

Armend Hamiti  
Anëtar

**KOMISIONI DISIPLINOR :**

Omer Daku  
Kryetar

Blerim Vuniqi  
Anëtar



Vendimi i dërgohet:

- KB Trepça dhe z.Lindrit Misini
- Gjyqtari Elldin Uglari
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së
- Komisionit të Garave
- Arkivit të FBK-së

**Kosovo Basketball Federation**

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

